



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË

Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla e të Mesme
Drejtoria e Privatizimit të Sektoreve Strategjike

URDHËR
Nr. 201 / Datë 22.7.2005

PËR
PRISHJEN E SHOQËRISË ANONIME "AEROPORTI NENE TEREZA" SH.A
TIRANË

Drejtuar: Shoqerise Anonime "Aeroporti Nene Tereza" Sh.a.


TIRANE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenit 1 të Ligjit nr. 8885, datë 22.04.2002 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, ndryshuar me akte të tjera ligjore"; të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", nenet 189, 263 e vijues, për shkak të dhenies me koncension të Aeroportit Nderkombëtar Nene Tereza, humbjen e objektit kryesor të punës, me cilësinë e zotëruesit të 100% të aksioneve të shoqërisë "Aeroporti Nene Tereza" Sh.a Tirane,

URDHËROJ:

1. Prishjen në rrugë gjyqësore të shoqërisë "Aeroporti Nene Tereza" Sh.a, Tiranë e regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 20819, datë 15.02.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 20819/3 date 25.03.2000.
2. Caktimin si likuidator të Shoqërisë zj. Mirela Osoja, me page mujore 90,000 leke.
3. Të hartohet dokumentacioni në përputhje me dispozitat e Seksionit të V të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike në Ministrinë e Ekonomisë të ndjeke depozitimin e Urdherit në Gjykatën e Shkalles së Parë Tirane.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Nëseohet me origjinalin

Pri St. Legjive



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
KABINETI

URDHER

Nr. 24, Date 30.03 2006

PER EMERIM LIKUIDATORI

DREJTUAR: SH.A "AEROPORTI NENE TEREZA"

TIRANE

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise; nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 " Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 " Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore", te ligjit 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare", me cilesine e zoteruesit te vetem te kapitalit te shoqerise " Aeroporti Nene Tereza", shoqeri ne likuidim e siper Tirane,

URDHEROJ:

1. Shkarkimin e Zj. Mirela Osoja nga likuidatore e shoqerise "Aeroporti Nene Tereza" Tirane.
2. Emerohet likuidatore e shoqerise "Aeroporti Nene Tereza" Tirane, Zj. Rudina Fortuzi, ekonomiste e larte, me page mujore 60 000 leke.
3. Ngarkohet shoqeria per depozitimin e Urdherit ne Gjykatën e Shkalles se Pare, Tirane.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTER
GENCBULI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER


Nr. 814, date 15.11.2006

Ne mbeshetje te ligjit nr.7626, date 20.05.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", te ndryshuar, dhe te nenit 128 te ligjit nr.7368, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", te ndryshuar, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise;

URDHËROJ:

1. Nderprerjen e procedurave te likuidimit te shoqerise "Aeroporti Nene Tereza" sh.a. Tirane.
2. Vazhdimin e veprimtarise se kesaj shoqerie, si shoqeri tregtare.
3. Urdheri nr.201, date 22.07.2005, i Ministrit te Ekonomise per prishjen e shoqerise "Aeroporti "Nene Tereza"" sh.a dhe shpalljen e saj si "shoqeri ne likuidim e siper" shfuqizohet.
4. Ngarkohet shoqeria per depozitimin e ketij urdheri ne Zyren e Rregjistrimit Tregtar prane gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

Ky urdhër hyn në fuqi menjeherë .



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 20819/11

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 08/08/2005, une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane M. Meca, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te urdhrin nr.201 date 22.07.2005 te Ministrit te Ekonomise:

K O N S T A T O V A :

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr. 20819 date 15.02.1999 eshte regjistruar si person juridik Shoqeria "Aeroporti Nene Tereza" sh.a.

Me urdher nr.201 date 22.07.2005 te Ministrit te Ekonomise" është urdheruar:

1. Prishja e shoqerise "Aeroporti Nene Tereza" sh.a
 2. Caktimin si likuidator te shoqerise znj.Mirela Osoja.
- Për sa më sipër kërkohet depozitim prane regjistrin tregtar te ketij vendimi.
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E :

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 per "Shoqerite Tregtare" dhe 7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar"

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne regjistrin tregtar te urdhrin nr.201 date 22.07.2005 te Ministrit te Ekonomise per

1. Prishja e shoqerise "Aeroporti Nene Tereza" sh.a.
2. Caktimin si likuidator te shoqerise znj.Mirela Osoja.
3. Shpalljen e shoqerise si "Shoqeri ne likujdim e siper".

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregtar.

G J Y Q T A R E

B L E R I N A M E C A



VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë sot më datë 26 Dhjetor 2006 unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Majlinda Dogga, mora në shqyrtim kërkesën dhe aktet e paraqitura nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe

K O N S T A T O V A

Se me Vendimin Nr.20819 datë 15.02.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është rregjistruar si person juridik shoqëria anonime Albtransport Sh.a.

Sipas dokumentacionit të depozituar pranë zyrës së regjistrimit tregtar emërtimi i ri i shoqërisë është "Aeroporti Nënë Tereza" Tiranë Sh.a.

Me vendimin Nr.20819/11 datë 08.08.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është depozituar urdhëri i Ministrit për shpalljen e shoqërisë në likuidim e sipër dhe emërimin e znj. Mirela Osoja në detyrën e likuidatores.

Me vendimin Nr.20819/12 dt.28.04.2006 është depozituar urdhëri i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës për shkarkimin e znj.Mirela Osoja dhe caktimin e znj.Rudina Fortuzi si likuidatore.

Me urdhërin Nr.814 dt.15.11.2006 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është urdhëruar:

Ndërprerjen e procedurave të likuidimit të shoqërisë "Aeroporti Nënë Tereza" sh.a Tiranë.

Vazhdimin e veprimtarisë së kësaj shoqërie, si shoqëri tregtare.

Urdheri Nr.201 date.22.07.2005, i Ministrit të Ekonomisë për prishjen e shoqërisë "Aeroporti Nënë Tereza" sh.a dhe shpalljen e saj si "shoqëri në likuidim e sipër" shfuqizohet.

Ngarkohet shoqëria për depozitimin e urdhërit në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kërkesa është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në mëbshtetje të ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjit 7667 datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar"

VENDOSA

Depozitimin e urdhërit Nr.814 dt.15.11.2006 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës sipas të cilit është urdhëruar:

Ndërprerjen e procedurave të likuidimit të shoqërisë "Aeroporti Nënë Tereza" sh.a Tiranë.

Vazhdimin e veprimtarisë së kësaj shoqërie, si shoqëri tregtare.

Urdheri Nr.201 date.22.07.2005, i Ministrit të Ekonomisë për prishjen e shoqërisë "Aeroporti Nënë Tereza" sh.a dhe shpalljen e saj si "shoqëri në likuidim e sipër" shfuqizohet.

Ngarkohet shoqëria për depozitimin e urdhërit në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Urdhërohet zyra e regjistrimit tregtar të pasqyrojë ndryshimet në skedën e shoqërisë, duke i ndarë regjistrimet nga njëri tjetri me vijë të kuqe.

GJYQTARE
Majlinda DOGGA

